

VENDIM
Nr. 498, datë 10.9.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH
TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR
FINANCIMIN SHITESË PËR PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË INTEGRUAR URBAN
DHE TURIZMIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 70/2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për projektin e zhvillimit të integruar urban dhe turizmit, ratifikuar me ligjin nr. 70/2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 15268/8 Prot.

Tiranë, më 8/5/2025

Lënda: Mbi Projektin "Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmi"

ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE ✓
Adresa: "Dëshmorët e 4 Shkurtit", nr. 34, Tiranë


Në vëmendje të: **XIAOQING YU**
Drejtoresh Rajonale, Ballkani Perëndimor

Referuar Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për Projektin e "Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit", me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve për t'u financuar nga kjo marrëveshje nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

- shtyrjen deri më 30 Qershor 2026, të afatit të parashikuar sipas skedulit 2, seksionit III, pika B të Marrëveshjes së Huasë për financimin shtesë.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë për Projektin e "Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit".

Ky ndryshim hyn në fuqi, në datën e njoftimit nga pala shqiptare të Bankës Botërore mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.



XIAOQING YU
Drejt看, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

29 maj 2025

Drejt看: SH.T. Petrit Malaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr. 3, Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

I nderuar Z. Ministër,

*Financim shitesë për Projektin “Zhvillimi i Integruar Urban dhe Turizmi”
(Huaja BNRZH nr. 9326- AL)
Zgjatja e Datës së Mbylljes*

I referohemi Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”) të datës 29 korrik 2022, për Projektin e lartpërmendur, dhe letrës tuaj të datës 8 maj 2025, me anë të së cilës Bankës i kërkohet zgjatja e Datës së Mbylljes të huasë së ofruar të lartpërmendur, të parashikuar sipas Marrëveshjes së Huasë.

Kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka ka caktuar datën 30 qershor 2026 si datën më të vonshme për qëllime të Seksionit III.B.2 të Skedulit 2 të Marrëveshjes së Huasë.

Me respekt,
(Nënshkrimi)

Xiaoqing Yu
Drejt看 Rajonal për Ballkanin Perëndimor
Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore

Në vëmendje të: SH.S. Belinda Balluku, Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
SH.T. Blendi Gonxhja, Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
SH.S. Mirela Kumbaro-Furxhi, Ministre e Turizmit dhe Mjedisit
Znj. Erjona Bejleri, Zëvendës Ministre e Financave
Z. Sokol Duma, Zëvendës Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
Z. Hantin Bonati, Zëvendës Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë
Z. Dritan Agolli, Drejt看 Ekzekutiv, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)
Znj. Eridana Çano, Drejt看 e SASPAC-ut
Z. Matteo Bugamelli, Drejt看 Ekzekutiv, Banka Botërore